



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.698/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)- dega në Junik, e paraqitur kundër Demokratik Ganiyaj, anëtar i Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të Thyerjes së Heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa:Anr.698/2021 e datës 21.10.2021, e paraqitur nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)- dega në Junik, kundër Demokratik Ganiyaj, anëtar i Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)- Thyerja e Heshtjes Zgjedhore përmes rrjetit social-FB.

A r s y e t i m

Me datë 21.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.698/2021, e dorzuar në postë më datë 18.10.2021, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)- dega në Junik e paraqitur kundër Demokrat Ganija, Anëtar i Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendohet se Demokrat Ganija, anëtar i LDK-së ka thyer Heshtjen Zgjedhore duke bërë dy postime në rrjetin social-FB, dy orë para fillimit të votimit duke promovuar kandidatin për kryetar nga subjekti i tij politik LDK.

Ankesës iu është bashkangjitur tri fotografi të printuara si provë materiale.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar me datë 17.10.2021, Demokrat Ganija, anëtar i LDK-së, e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e Heshtjes Zgjedhore dhe ditën e votimit.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e Heshtjes Zgjedhore dhe Ditën e Votimit, edhe pse parashtruesi i ankesës ka paraqitur fotografi me të cilat pretendon se postimi i sponsorizuar ka qenë aktive në Ditën e Votimit, paneli këto pretendime nuk mundi ti vërtetoj sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamës të shkelësit të supozuar siç pretendohet në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.698/2021 më datën 22.10.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa*